

MBIVENDOSJA E DISA ELEMENTEVE KANURORE NË KONTEKST TEJKOHOR

Fatjona ABDULLAHI¹

¹ *Department of Albanian Language and Literature, Faculty of Philology, University of Tetova*

^{*} *Corresponding author e-mail: fatjona.abdullahi@unite.edu.mk*

Abstract

The Kanun is a complex set of legal norms that has been preserved to the present day through structures that ensured adherence and punished violations. However, today, these structures no longer exist because the Kanun was characteristic of closed societies. As a result, its implementation has become distorted, and some elements have been preserved in an altered form. The Kanun reflects the legal systems of past times, such as the Byzantine, Roman, and Greek codes, leading to the conclusion that it was not a comprehensive set of popular legal norms but rather a collection of isolated constitutional elements. On one hand, the Kanun can be seen as a liberating element, showing that society was organized in some form. However, what is problematic now is the imposition of the Kanun in modern times when the rule of law is already established.

Keywords: Kanun, law, rules, literature, society, historical context.

Rrethanat tejkohore dhe zbatimi i rregullave kanunore

Qëndresa shumëshekullore e shqiptarëve, arti dhe kultura në mjediset idilike e pastorale, shpirti dhe fryma e guximshme e një populli me rrënjë të thella në lashtësi, për më shumë se pesëqind vjet ka mbajtur një strukturë administrimi e cila ka qëndruar si hierarki e paprekshme edhe atëherë kur shqiptarët pushtoheshin dhe u jepej mundësia “ta dënonin veten me ligjet e veta”. Për ta mbajtur një rregull dhe organizim jetësor, bëheshin pakte normash të cilat sa më të hershme që të ishin, aq më shumë predisponoheshin për t’u kthyer në kulte. Këto sisteme të dala nga vetë populli, jo rrallë bashkëpërkonin me qëllimet e errëta të pushtuesve, sidomos të osmanëve të cilët kurrë nuk e morën mundimin të ndërhyjnë në këtë sistem rregullash siç ndërhyjnë dhe bëjnë represion në çdo sistem tjetër, arsimor, fetar e sidomos kulturor.

Ky fakt, lë të kuptohet se qeverisja që bëhej në të aushtuqajturat bajraçe apo organe administrative, shpesh e çonte ujën pikërisht në vadenë e Portës së Lartë, në mënyrë ndoshta edhe të pavetëdijshme. Qeverisja bëhej me rregulla të cilat shërbenin për organizim të jetës së shqiptarëve dhe zbatimi ishte i domosdoshëm, sidomos në Shqipërinë e veriut ku edhe qarkullonin numri më i madh i kanuneve dhe dekreteve të ngjashme. Kanuni është kompleks normash juridike i sjellë deri në ditët tona përmes strukturave që e mbikëqyrnin respektimin e kanunit dhe ndëshkonin mosrespektimin e tij.

Por sot, strukturat kanunore nuk ekzistojnë më sepse kanunet janë karakteristike për shoqëri të mbyllura dhe pikërisht për këtë kemi deformim të implementimit kanunor dhe ruajtje të disa elementëve në formë të shpërfytyruar. Në Kanun reflektohen sistemet juridike të kohëve të kaluara si p.sh. kodi bizantin, romak, grek etj. gjë e cila na çon drejt konkludimit se kanuni nuk ishte tërësi normash popullore ligjore që kanë shërbyer si kushtetuta të vogla të izoluar. Kanuni nga njëra anë mund të shihet edhe si element emancipues që tregon se shoqëria organizohej në njëfarë forme, por ajo që është e dëmshme tani është mbivendosja e kanunit në ditët e sotme kur funksionon shteti ligjor dhe gjakmarrja shpesh ngatërrohet me hakmarrjen.

Kanuni i Lekë Dukagjinit si më i njohuri edhe në ditët e sotme ndër shqiptarë, dikur zëvendësonte kushtetutën dhe ishte një formë paraprijëse e së drejtës penale, e cila i tejkalonte kufijtë ligjor. Në njëfarë forme kanuni respektohej deri në hymnizim dhe Lekë Dukagjini jo rrallë e shohim të krahasohet me Homerin që e barti atë, në kujtesën kolektive të popullit brez pas brezi dhe gojë më gojë, rregulloren në bazë të së cilës funksiononte Principata e Dukagjinëve dhe përgjithësisht veriu i Shqipërisë. Lekë Dukagjini ishte bashkëkohanik i Skënderbeut dhe meritat për ruajtjen autentike të Kanunit i atribuohen Atë Shtjefën Gjeçovit, i cili e solli në versionin të cilin supozohet që ta ketë përshtatur, duke iu referuar rëndësisë që i jep kishës dhe klerit fetar, gjë e cila sipas disa studiuesve nuk përkon me Kanunin origjinal.

Kanuni i Lekë Dukagjinit është unikal si shkrim e përmbledhje e ligjit të pashkruar të fiseve malësore të Shqipërisë së veriut. Ky kanun ishte ai që drejtonte dhe rregullonte sjelljen në shoqëri, madje çdo anë të jetës në trevat e veçuara e të thella të malësisë së veriut. Ai respektohej me rreptësi nga fiset dhe kishte përparësi mbi çdo legjislacion tjetër, qoftë ekleziastik apo laik, që orvatej të zinte vend në malësi. Me anën e këtij kodi ligjor të lashtë fiset malësore qenë në gjendje të ruajnë identitetin e tyre, autonominë e tyre, edhe pse për pesë shekuj me radhë qenë zyrtarisht pjesë përbërëse e Perandorisë Osmane.

Vëzhguesit të sotëm mund t'i duken barbare disa aspekte të Kanunit si përcaktimi i gjakmarrjes si mjet i kërkimit të drejtësisë dhe statusi tepër inferior i gruas, së cilës i mohoheshin jo vetëm të drejtat e privilegjet e burrit, por edhe të gjitha detyrat e tij. Megjithatë, këto tipare vetvetiu pasqyrojnë realitetin social të fiseve patriarkale që aq shumë i nënshtroheshin gjakmarrjes. (Elsie 1997:153) Kanuni i Lekë Dukagjinit është i fragmentarizuar në 11 libra, tek të cilët janë të parapara ligje me të cilat rregullohen çështje të rëndësishme të organizimit të jetës së shqiptarëve. Pra libri i parë i takon kishës, i dyti familjes, në librin e tretë rregullohet martesja, libri i katërt i takon gjasë, shtëpisë dhe pronës, libri i pestë punës, libri i gjashtë të dhanunat, i shtati parashihte fjalën e gojës, i teti nderin, i nënti dëmet, i dhjeti njihet si kanuni kundra mbrapshtivet ndërsa i njëmbëdhjeti quhej kanuni i pleqnis.

Gjuha e Kanunit, sipas studiuesve, është mjaft e vështirë dhe kjo, jo duke iu referuar dallimeve dialektore, respektivisht gegnishtes së përdorur, por referuar dykuptimësisë apo shumëkuptimësisë së fjalëve dhe termave të caktuar në kontekste të ndryshme. Fjala “kanun”, mendohet të ketë prejardhjen nga greqishtja e vjetër, sipas pretendimit të Fishtës në parathënien e Kanunit të Lekë Dukagjinit të sjellë nga Atë Shtjefën Gjeçovi, respektivisht nga termi anon që do të thotë: *mastar-njajo vegël drunit a ndonjë brumit tjetër, qi vien me tërhekë viza të ndrejta. Metaforikisht shënjon shtillin e ligjvet gojdhansë e të pakodifikueme, mbas të cillavet hecte dikur hullija e jetës e e veprimt të popullit shqyptar.*

Sipas Kristo Frashërit, prejardhja e fjalës ka burim bizantin, nga fjala kanon, ndërsa autorë të tjerë i japin etimologji turke të barazvlefshme me fjalën *kanunname*. Por, pavarësisht burimit të fjalës dhe etimologjisë së termit kanun, ajo që është e rëndësishme të thuhet është fakti se termi kanun gjeti përdorim në gjuhën e popullit shqiptar dhe luajti rol të rëndësishëm në jetën e popullit shqiptar dhe në organizimin shoqëror të shqiptarëve. Kanuni ndryshe mund të shpjegohet si përmbledhje ligjesh e normash të pashkruara, të trashëguara brez pas brezi, që pasqyrojnë gjendjen ekonomike-shoqërore të periudhave të kaluara dhe që në kohën e vet mbronin interesat e klasave e të shtresave të caktuara shoqërore.

Institucioni i gjakmarrjes në Kanunin e Lekë Dukagjinit

Pavarësisht faktit se kanuni ishte një rregullator i jetës së shqiptarëve, edhe sot e kësaj dite vazhdon të njihet, madje edhe të jetë aktual, për dukurinë plagë të shoqërisë shqiptare siç është gjakmarrja. Ky fenomen i vëllavrasjes është i lashtë sa vetë njeriu dhe në rastin e shqiptarëve ishte edhe i kodifikuar dhe i organizuar edhe juridikisht. Kanuni i Lekë Dukagjinit nuk është i vetmi kanun, pasi që përkrah tij kishte edhe kanune të tjera, të cilat kryesisht i takojnë veriut dhe më pak jugut (Kanuni i Labërisë), Kanuni i L. Dukagjinit – varianti i Pukës, Kanuni i L. Dukagjinit – varianti i Mirditës – Xhemal Peçi, Kanuni i Skënderbeut – Frano Ilija (zona e Kurbinut) dhe Kanuni i Lumës i mbledhur nga Shefqet Hoxha i cili nuk është botuar etj.

Është karakteristike se në Kanunin e Labërisë gjakmarrja është dukuri jo shumë relevante, ndërkaq në kanunet e tjera, gjakmarrja është institucion. Megjithëse në një pikë bashkohen studiuesit; se Kanuni i Lekë Dukagjinit, nuk e shpiku gjakmarrjen, duhet thënë se e përligji atë, duke i dhënë përmasat e një institucioni të formësuar me kode të përcaktuara qartësisht. *Kush vret, vritet* – është parimi kryesor, i cili më tej, parashihet me dispozita të caktuara që edhe të degëzohet dhe vrasja të shpërndahet qoftë edhe në njerëz të pafajshëm, vite, madje edhe dekada, pasi fajtori të jetë harruar.

Gjakmarrja, ndonëse shumë e pakësuar në Shqipëri pas Luftës së Dytë Botërore, prapëseprapë ka mbetur një tipar i shoqërisë shqiptare në veri, sidomos në Kosovë, ku realisht mijëra familje kanë rënë në grackën e riteve të gjakut dhe kanë mbetur të ngujuara edhe sot e kësaj dite. Një fushatë kundër gjakmarrjes më 1990, e drejtuar nga një komitet intelektualësh të shquar shqiptarë të Kosovës dhe në veçanti nga etnografi Anton Çetta (1920-1995), shpuri në pajtimin e mbi nëntëqind gjaqeve nëpërmjet skenash emocionuese dramatike të tubimeve të mëdha.

Një nocion i kanunit fisnor, që ende shihet me një farë adhurimi apo të paktën mrekullimi, është ai i besës, mbajtja absolute e fjalës së dhënë, çfarëdo që të ndodhë. Kanuni i Lekë Dukagjinit ka qenë objekt që ka tërhequr mjaft historianë, specialistë të drejtësisë dhe etnografë, jo vetëm në Shqipëri e në Kosovë por edhe më gjerë. Kanuni është përkthyer italisht nga Pal Dodaj (Romë 1941) dhe anglisht nga Leonard Foks (Leonard Fox) (Nju Jork 1989). (Elsie 1997:153) Në vitet e tridhjeta gjithashtu ka pasur misione të mëdha pajtimi gjaqesh sidomos nga jezuitët ku grupe të mëdha priftërinjsh mblidheshin për të kryer pajtimin e gjaqeve i cili po ashtu parashihet në Kanun.

Statistikat e vrasjeve në shek. XX shihet se tregonin shfarosjen e meshkujve shqiptarë nga gjakmarrja, edhe atë për dy arsye kryesore; për çështje sedre dhe si njëfarë detyrimi ligjor, moszbatimi i të cilit shoqërohej me presion të madh social i cili manifestohej me dhënien e kafes nën gjunjë siç e parashihte Kanuni, për secilin pjesëtar të gjinisë mashkullore mbi 18 vjet, i cili kishte lejuar që të fillonte të zbehej gjaku në këmishën e të vrrarit e cila qëndronte e varur në oborrin e shtëpisë derisa të merrej gjaku i të vrrarit. (Elsie 1997:153)

Nga mesi i viteve të 20-ta, në kohën e Ahmet Zogut, pavarësisht se shteti mori përmasa monarkie, kjo nuk kishte ndikim në fenomenin e gjakmarrjes në veri të Shqipërisë. Ndërsa, nga 1944 deri në vitin 1991, komunizmi e bëri punën e vet në “mpirjen” e dukshme të gjakmarrjes. Të njëjtën nuk mund ta themi për Kosovën Perëndimore ku gjakmarrja vazhdonte të ishte fenomen i përhapur masovikisht dhe si rrjedhojë, siç thamë, populli i Kosovës sikur filloi ta ndjente avantazhin që i jepte Serbisë vrasja brenda sojit, prandaj u shfaq fushata e njohur e Anton Çetës për pajtimin e gjaqeve, e cila përfshiu diku rreth 4000 familje dhe 900 gjaqe të falura.

Megjithatë, në disa vise më të izoluar dhe me popullsi më konservatore, edhe sot e kësaj dite ka raste të gjakmarrjes, ndonëse janë më sporadike. Për dukuritë, gjenezën e të cilave e kemi të pamundur ta dimë dhe shkaqet i kemi të njohura vetëm në kontekstin e ndërlidhur me pasojën, është më se e natyrshme që të ketë aludime të cilat në njëfarë forme i japin shpjegim vetëm rezistencës së fenomenit ndër shekuj, por jo edhe zanafillës.

Kur lindi gjakmarrja dhe kur u kodifikua në përmasat e një institucioni? Çfarë e mbajti gjallë ndër shekuj dhe kujt i leverdiste sanksionimi i padiskutueshëm i gjakmarrjes, edhe në kohën kur shqiptarët ishin të pushtuar nga Perandoria Osmane? Përse parimi i reciprocitetit, ose vrasja kokë për kokë pësoi ndryshime me kalimin e kohës dhe gjakmarrja pësoi degëzimin e saj edhe në njerëz të cilët nuk ishin dorëras vetë, por mund të ishin të afërm të tjerë të gjinisë mashkullore?

Në literaturën etnografike dhe antropologjike perëndimore, shqiptarët e veriut janë portretizuar shpesh si një "racë malësorësh të vështirë, preokupimi kryesor i të cilëve ka qenë të luftonin mes njëri-tjetrit sa herë që nuk ishin të angazhuar në luftë me dikë tjetër". (Scriven: 1918) George Scriven konsideronte se "Jetët e tyre janë shuar në konflikt të vazhdueshëm me natyrën;...ata janë mësuar që në foshnjëri të luftojnë kundër njeriut po aq instiktivisht sa edhe kundër elementëve shkatërrimtarë të natyrës".

Ndërsa, Gabriele Annan shprehet se "Malësorët e fiseve veriore kishin vetëm një interes dhe një hobi: gjakmarrjen. Pothuajse çdo gjë mund të merrej si fyerje dhe poshtërim që duhej hakmarrë vetëm me vrasjen e fajtorit apo të një anëtarit të familjes së tij...Pothuajse çdo familje ishte në 'gjak' me dy apo tre të tjera".(Annan: 1988) Konstatime të tilla, vijnë pas tendencës për t'i dhënë shpjegim sa më logjik kësaj dukurie ose për ta klasifikuar ndoshta si çrregullim social që mund të përcaktohet në varësi të pozicionimit gjeografik, ku dukshëm dallojnë veriorët nga jugorët edhe si tipologji dhe karaktere.

Miku si kult dhe si shkak për derdhjen e gjakut

Në kodet kanunore bëhej një përlllogaritje e mirë se cili nen ishte i ndryshueshëm dhe kush nuk guxonte të merrte trajtë tjetër nga ajo që ishte përcjellë në vazhden shekullore dhe kjo nuk ndodh në mënyrë krejt të rastësishme, por ka funksionalitetin e vet brenda fenomenit. Bie në sy, rigjiditeti me të cilin karakterizohet kulti i mikut dhe sidomos akti i prerjes së mikut në besë. Në qoftë se mund të bëhen pakte me normat e tjera siç është pagesa e tagrit për dëmet materiale, ose ndryshimet në ceremoninë e martesës a të fejesës, një rregull nuk guxonte kurrsesi të riformësohej: *Me gojë të kanûnit: baba, vllau e deri kushrinija e dalun fare falet, porsë miku nuk falet (posë me të hîm ndermjet të dashamirvet të zëmres)*. Pra, poshtërimi më i madh për të cilin do dedhej gjaku se s'bën ishte prerja e mikut në besë: *Po i u pré kuej miku, kanûja i kà lânë dy udhë: a të fiket, a të koritet, ose Atij, qi i u pré miku, çdo send do ti epet me dorë të mâjtë e per rien giu mjé qi t'a paguej mikun*. (Gjeçovi 1993: 116)

Miku, nga ana tjetër, ishte çdo njeri i cili të trokiste në derë dhe kërkonte besën: *Po të hîni miku në shpi, gjak me të pasë, do t'i thuejsh: "Mirë sè erdhe!"* (Gjeçovi 1993: 116). Pra, mund të ndodhte madje, që edhe vetë gjakësi të kërkonte besën në shtëpinë e shqiptarit dhe ai do ta pranonte, duke e mbrojtur nga çdo rrezik që mund t'i kanosej, deri në momentin e përcjelljes larg shtëpisë, të cilën gjë e vendoste po miku se deri ku do të përcillej. Për botëkuptimin e gjithsekujt që nuk e njeh kultin e mikut, kjo dukuri mund të konsiderohet krejtësisht absurde, megjithatë dispozitat e parashohin shprehimisht se shtëpia e shqiptarit, përpara se të jetë e vetja, asht e Zotit dhe e mikut.

Kadareja, bën një parantezë në romanin e tij, duke përqasur kultin e mikut me kultin e zotave mitologjikë: *A nuk shfaqeshin befasisht, në mënyrën më të papritur, hyjnitë e grekëve të vjetër? Ja, kështu shfaqet miku te porta e shqiptarit. Dhe, si gjithë hyjnitë, ai është plot enigmë dhe vjen drejt e nga mbretëria e faut, apo fatalitetit, quaje si ta duash. Trokitja e tij është e tillë, saqë brez a të tërë njerëzorë mund të vazhdojnë të jetojnë ose të shuhen nga kjo bote për shkak të saj. Ja, ky është miku*. (Kadare 2015: 243). Miku dhe besa, ishin dy nga shkaqet më të shpeshta për të cilët mund të fillonte derdhja e gjakut, por nuk ishin të vetmet arsye. Për më tepër përbri shkaqeve të gjakmarrjes nga prerja e vadesë, prishja e fejesës apo martesës dhe lëvizja e kufirit, mund të thuhet se gjaku i derdhur për mik të prerë e për besë të prerë, edhe sot e kësaj dite tingëllon frikshëmrisht madhështor.

Gruaja dhe raporti i saj me gjakun, në kanun

Në Kanunin e Lekë Dukagjinit, thuajse asnjë element nuk mbetet i padefinuar e i pasanksionuar dhe pretendohet për të drejta të barabarta ndërnjerëzore, paçka se në shumë vende shohim një lloj mizogjinie e cila edhe sot e kësaj dite përlligjet dhe pranohet duke e bërë shoqërinë shqiptare dukshëm patriarkale në thelb. Shihet një diskriminim i hapur i gruas në realitetin shqiptar shprehimisht: *Grueja asht shakull per me bajt. Grueja njifet si një calikë per me bajtë sa të jetë në derë të burrit, se prindja se hjekin dorë prej sojet, e ndalin per vedi e mbi vedi të të pergjegjmen per te, por edhe me lypë arsye, me ba me gjetë gja.* (Gjeçovi 1993: 36)

Pra, gratë shiteshin si prona nga babai ndërsa pas martesës lirisht mund të vriteshin nga burri, (në rast tradhtie apo mosbindjeje), edhe atë me plumbin e pajës të cilin vetë i ati ia jepte të bijës në ditët kur e përcillte për martesë. Në Kanun, prerazi parashihet si mund të vritet gruaja me plumbin e pajës, në rast se është nevoja që asaj “t’i pritët theku”, pra “të lëshohet” gruaja nga burri: *Po s’u pru grueja si duhet te burri, kanuja i nep leje me i pre thekun a flokun e me lshue. Kunora jet, e as burri as grueja nuk mund të martohen për të gjallët. Po u qortue grueja, mbas të lutmes së dashamirve, qillon qi burri e merr perseri. Per dy punë e ka fishekun në shpinë grueja e per nji punë i pritët theku e lshohet. a) per kurvni; b) per mik të prem.*

Per këto dy punë të pabesijet i shoqi e vret të shoqen, e rrin pa ndore, pa besë e pa kenë i ndjekun për gjak, se prindja e nuses së vrame marrin çmimin e gjakut, e këtij do t’i napin fishekun e do t’i qesin dorëzanët. Per bracni a cubni burri e lshon gruen porse tjetër dhunë s’ka tager me i ba grues. Grueja, qi lshohet, tuj dalë shpijet të burrit, kurnji send s’ka tager me marrë me vedi posë petkash, qi ka në shtat. I hupin petkat grues së lshueme, perse çmimi, qi ka pasë la burri per të, i jet ke prindt. Me pasë djalë prej gjiut grueja e lshueme, i shoqi, edhe pse e din kathedret, asht në detyrë me i a shenjue nji vend rreth plangut të vet, me i a dhanë djalin e me mbajtë me vesh e me mathë e me bukë. (Gjeçovi 1993: 38)

Gruaja dukshëm e ka të mohuar vendimmarrjen dhe shmangien nga rregullat që parashihen për fejesën, martesën, ndarjen etj., pra, roli i saj është krejtësisht pasiv. Megjithatë, ky rol mund të ndryshojë vetëm në një rast që lidhet me gjakmarrjen, pavarësisht se gratë nuk preken nga ky fenomen. Në rastin kur dy familje ishin në gjak, gruaja mund të luante rolin e ndërmjetësueses për faljen e gjakut, gjë e cila sidoqoftë nuk ndodhte shpesh. Kanuni e parasheh që: *“Grueja s’bjen në gjak” edhe me qillue se vret kend. Me vra grueja burrin e vet a kedo, prindja e kësaj do t’apin arsye per at gjak. Burri e blen mundin e të jetuemt e grues, por jo jeten e saj. Me gjetë gja gruen per faj të burrit, prindja e kësaj i lypin arsye më kanu. Me rrahë burri gruen, nuk bie në faj kah kanuja, e as prindja s’mund t’a kerkojn të rrahmen. Me plyrë burri gruen, e po bani vaj kjo ke prindt, burri do t’u apë arsye. Me mbytë grueja burrin, e m’u çue i kunati me vra të kunaten, pse i a vrau të vllan, kjo s’asht e perlligjme më kanun. – Gjaku i grues s’bahet krahas me gjak të burrit; pra, tepricen e gjakut të burrit do t’a perlligjin prindja e grues. Sikurse janë në detyrë prindja me dhanë arsye per çdo punë të ligë qi të bajë në derë të burrit a kuejdo bija e tyne, ashtu çmimin e gjakut të saj.* (Gjeçovi 1993:35).

Siç mund të shihet, Kanuni e përjashton gruan nga gjakmarrja me arsyetimin se gjaku i burrit nuk mund të jetë i barabartë me gjakun e gruas, por gjithsesi, në rast vrasjeje, gjaku do të merrej në familjen e gruas, respektivisht në pjesëtarët e gjinisë mashkullore, siç mund të jenë babai, vëllai apo edhe kushërinjtë e largët. Dispozita e këtillë, dukshëm nuk e kursen derdhjen e gjakut, përpos që e përjashton gruan nga shpagimi, vetëm në plan individual, gjë e cila nuk e pengon zinxhirin që të zgjerohet.

Gruaja, respektivisht vajza nuk kishte të drejtë të zgjidhte për bashkudhëtarin e jetës së saj, ndaj edhe shumë martesë ishin pasuese të fejesave që në djep, të cilat pastaj shoqëroheshin me një tjetër fenomen, të njohur si shndërrimi i grave në burra. *Vajza nen unazë nuk ka tager me lshue djalin. Vajza e xanun nuk mundet me e lshue djalin edhe në mos e pasët per sy. Po s’ndegjoi vajza me shkue m’at fat, qi e ka xanë, e edhe prindja i perkrahen së bis, kjo s’mund*

të martohet ma per të gjallët e dhandrrit me tjeterkend. Prindja e vajzës janë detyrë me i a kthye shpis së dhandrrit mje në ma të mbramin dys, qi kan la per at vajzë. (Gjeçovi 1993: 25)

Në rast të vdekjes së burrit, gruaja rimartohet me njeriun që ia përzgjedhin, dhe në rast se e kundërshton atë vendim pason ndëshkimi me vrasje pa obligimin e shlyerjes së gjakut, sepse vetë vrasja kryhet me plumbin e pajës së saj: *Po s' nigioi vajza me shkue m'at fat, qi e pat xanë, edhe me perdhuni do t'ia apin atij, qi e ka xanë me "Fishek më shinë"; e per n'i raftë per sy vajza tue hikun, ky e vret me fishek të prindës së saj, e gjaku i vajzës shkon hupës, per arsye qi me fishek të tyne e vrau.* (Gjeçovi 1993: 26)

Ajo që është më karakteristike, është se në qoftë se vajza nuk pranon të martohet me të fejuarin e saj, prindërit detyrohen që ta paguajnë deri në qindarkën e fundit familjen e dhëndrit dhe përsëri ajo nuk ka të drejtë të rimartohet ose ta kërkojnë dorën e saj derisa dhëndri është i gjallë, e për këtë në shenjë rikujtimi, mbesin 10 groshët e kanunit në arkën e vajzës. *Sheji e dhetë grosht e kanus, qi i janë çue vajzës kur u xu, do të jesin n'arkë të sajë deri ditën e dekës së dhandrrit; e të dije si vajza, si djali, si prindja se aj dhandrrit; e të dije si vajza, si djali, si prindja se aj shej s'i len me luejtë. Kah kanuja, vajza jet e lidhun, e veç me leje të dhandrrit qi e pat xanë e per në hjekët dorë ky, se s'mund të martohet, e s'a'kanun qi të shkojë tjeterkush me e lypë, si të dijë se gjindet e pengueme. Edhe po e muer tjetër grue dhandrri vajza e xanun prej tij jet e lidhun se e lidhun. Me dekë të dhandrrit, kanuja e liron vajzen, e, po desht, mundet të martohet per arsye qi "me dekë të dhandrrit, sheji xehet i hupun".* (Gjeçovi 1993: 27)

Ndërkaq, burmeshat ishin vajzat të cilat vendosnin të bënin jetën me një tjetër identitet, duke zgjedhur të mos martoheshin kurrë, në rast se ishin të pamartuara ose të fejuara me dikë që në djep e që në rast të prishjes së fejesës do të derdhej gjak. Këto vajza burmesha, prisnin gërshetat, merrnin pamjen e një burri me veshje dhe qëndrim, duke u bërë pjesë e odave të burrave e duke u bërë vendimmarrëse dhe duke i dalë zot shtëpisë e cila zakonisht ishte pa mashkull dhe madje shpesh si rrjedhojë e gjakut të derdhur. Por përveç se u lejohej të kuvendonin me burra, ato megjithatë, sikurse gratë e tjera nuk binin në gjak dhe këtë e shohim në librin e fundit të kanunit, ku tregohen përjashtimet: §.1228. - VIII. *Virgjinat (femnat, qi veshen si burrë): S'veçohen prei grash tjera, posë qi janë të liar me ndëjë nder burra, porsë pà tager zanit e kuvendit.* (Gjeçovi 1993: 185)

E drejta zakonore shqiptare, siç mund të shihet trajton çështjet më jetike deri tek dukuritë thujse të parëndësishme në jetën shoqërore, por mënyra me të cilën sanksionoheshin e mbante gjallë hierarkinë dhe rendin në përditshmërinë e malësorëve.

Përfundim

Pasi kemi dhënë disa nga segmentet ku shfaqet gjakmarrja në jetën shoqërore të shqiptarëve, e ndërlidhur me dallime gjinore, me kultin e mikut e të besës dhe me nderin vetjak e të shoqërisë, nuk do të ishte e tepërt pyetja se çfarë vlere kishte Kanuni i Lekë Dukagjinit në kohën që zbatoheshin përkrah kanuneve të tjera simotra dhe përveç vlerës juridike, cila mund të ishte vlere që do t'i mveshnim këtij kanuni në ditët e sotme? Juridikisht, vlerat e Kanunit kanë qenë të pakontestueshme në kohën kur ishte në fuqi, por mbivendosja e rregullave kanunore në ditët e sotme dhe sidomos për ligji e fenomenit të gjakmarrjes që edhe sot e kësaj dite, në zonat e thella të Lezhës e të Shkodrës, ose edhe në Kosovë, lë familje të ngujuara me vite, pa dyshim se nuk i atribuohet asnjë vlere qoftë morale e kulturore, qoftë edhe juridike.

Në qeverisjen e bajraqeve kur kanunet ishin format më akute të vendimmarrjes, prania e disa kanuneve dhe buja e madhe që e gëzon, sidomos Kanuni i Lekë Dukagjinit, mund të shikohet si shenjë emancipimi dhe mirorganizimi qeverisës. Por, në ditët e sotme kur ekziston shteti ligjor dhe rregullat janë të mirëdefinuara me kushtetutë, vlere e kanuneve dhe në këtë rast - e Kanunit të Lekë Dukagjinit, mbetet kryekëput në suaza të një monumenti kulturor të përsosur në zbatueshmërinë e tij në kohë tashmë të tejkaluar në çdo aspekt.

Referencat

- [1]. Annan, Gabriele (1988), *Roughing It*, The New York Review of Book 35: 20 (22 December).
- [2]. Çabej, Eqrem (1977), *Studime gjuhësore VI*, Prishtinë.
- [3]. Demaçi, Adem (1990), *Gjarpinjtë e gjakut*, Buzuku, Prizren.
- [4]. Demiraj, Shaban (1988), *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Shtëpia botuese e librit universitar, Tiranë.
- [5]. Elsie, Robert (1997), *Histori e letërsisë shqiptare*, Tiranë.
- [6]. Hysa, Mahmud (1996), *Shtjellime letrare*, Tetovë.
- [7]. Drini, Sulejman. Goçi, Ibrahim. Halimi, Mehmet. Gashi, Skender (1982), *Fjalor fjalësh e shprehjesh popullore*, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë.
- [8]. Gjeçovi, Shtjefën (1993), *Kanuni i Lek Dukagjinit*, Albinform, Tiranë.
- [9]. Kadare, Ismail (2015), *Prilli i thyer*, Onufri, Tiranë.
- [10]. Qosja, Rexhep (1984), *Historia e letërsisë shqiptare*, Rilindja, Prishtinë.
- [11]. Scriven, George P. (1918), *Recent Observations in Albania*, The National Geographic Magazine 34, 1: 90-114.